



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.2.2024

Nr: 18

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. QAZIM HALIL BICI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E
BASHKISË SHIJAK, QARKU DURRËS I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA
DREJTËSI INTEGRIM DHE UNITET (PDIU)**

Sot më datë 2.2.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU), në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, Neni 1, pika 2, shkronja “a” dhe neni 4, pika 1 të ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për



garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, më datë 29.03.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. DR-PDIU-8438 unik. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Qazim Halil Bici, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, Gjykata Verona,

- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, Qyteti Verona,
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”
- Pyetjes 5 “ A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, Aktualisht asnjë në fuqi.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti i vetëdeklarues ka jetuar në Itali për një periudhë 5 vjeçare për punë, në Gjermani për një periudhë 2 vjeçare për punë dhe në Norvegji për një periudhë 3 vjeçare për punë.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 5001 prot., datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 775/51 ex 23 prot., datë 04.01.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Qazim Halil Bici. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të ketë kryer, më datë 22.12.2003, ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga Gëzim në Qazim, si dhe rezulton të ketë përdorur dhe gjenealitete të tjera, në shtetet Itali dhe Gjermani, si:
 - Ardian Arukaj;
 - Gëzim Shala i lindur më 14/08/1978;
 - Albartimi Fabrizio i lindur më datë 12/02/1977;
- Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali, me vendimin nr. 91/2001 (99/98 Regj.Përgjithshëm), datë 22.02.2001 që ka lënë në fuqi vendimin e datës 21 shkurt 1997 të Gjykatës së Isernias, për faktin e kryerjes në bashkëpunim më 18 korrik 1996 në Isernia të veprës penale të transportit dhe shpërndarjes së lëndës narkotike të tipit heroinë, të parashikuar nga neni 110 Kodit Penal (italian), neni 73 e neni 74 te D.P.R. 309/90, duke e dënuar me 6 (gjashtë) vjet burg dhe 50 milionë lireta gjobë.

Me vendimin nr. 560, datë 26.07.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të njohë vendimin penal nr. 91/2001, date 22.02.200, të Gjykatës së Apelit të Campobasso në Itali, duke konvertuar, për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim;

- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qenë në hetim dhe gjykim, nga autoritetet e drejtësisë së Republikës së Italisë, për (a) veprën penale të parashikuar nga neni 110 Kodit Penal, 73 paragrafi 1 e 6 dhe 80 paragrafi 2 D.P.R. 309/90 sepse në bashkëpunim mes të pandehurit e tjerë, në mënyrë të paligjshme kanë transportuar më 18 korrik 1996 në Isernia me qëllim dhënie të tretëve, lëndë narkotike të tipit heroinë, rrethanë rënduese nga numri i bashkëpunëtorëve në veprë penale dhe nga sasia e madhe e lëndës narkotike të transportuar, duke qenë se bëhet fjalë për 514 gramë bruto të përshtatshme për t'u konfeksionuar në 8432 doza, (b) veprën penale të parashikuar nga neni 74 D.P.R. 309/90 sepse më 18 korrik 1996 janë bashkuar mes tyre dhe me subjekte të tjera të paidentifikuar, me qëllim kryerjen e disa veprave penale mes atyre të parashikuara nga neni 73 i D.P.R. 309/90, për të cilat nga Gjykata e Isernias me vendimin datë 21 shkurt 1997 është shpallur fajtor dhe dënuar me 10 (dhjetë) vjet burg e 100.000.000 lireta gjobë; përjashtuar nga ushtrimi i të drejtave ligjore gjatë kohës së dënimit kryesor që iu dha, dhe urdhëruar që mbas shlyerjes së dënimit të dëbohet nga shteti Italian. Pas ankimit të bërë kundër këtij vendimi Gjykata Apelit të Campobasso në Itali, me vendimin nr.91/2001 (99/98 Regj. Përgjithshëm) datë 22.02.2001, ka vendosur të mos e pranojë apelin e bërë dhe, mbas përjashtimit të rrethanave rënduese për sasinë e madhe, ka përcaktuar dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burg dhe 50 milion lireta gjobë. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs, nga Prokurori i Përgjithshëm, në Gjykatën e Kasacionit e cila ka lënë në fuqi vendimin më datë 20 prill 2001;
- Rezulton të ketë qenë i arrestuar në flagrancë më datë 17.01.2015, nga autoritetet e policisë së Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Kukës, si person në kërkim ndërkombëtar, në bazë të urdhër arrestit nr. 13/2001 të lëshuar nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali për ekzekutimin e vendimit penal nr. 91/2001, datë 22.02.2001, deri më datën 19.01.2015, kur me vendimin nr. 11, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur ta vleftësojë të ligjshme;
- Rezulton t'i jetë caktuar nga:
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 11, datë 19.01.2015, masa shtrënguese provizore e sigurisë personale "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, mbi bazën e shpalljes në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet ligjzbatuese italiane pasi Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali ka lëshuar urdhër arrestin nr. 13/ 2001 RES, për ekzekutimin e vendimit penal nr. 91, datë 22.02.2001.

Me vendimin nr.34, date 02.02.2015, Gjykata e Apelit Shkodër, ka urdhëruar lirim e menjëhershëm të këtij të arrestuari;

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 65, datë 18.03.2015, masa shtrënguese e sigurisë personale "Arrest në burg", në mungesë, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian në lidhje me nenet 73 paragrafi 1 e 6 dhe 80 paragrafi 2 DPR 309/90, për të cilin është dënuar me 6 (gjashtë) vjet burgim, me vendimin penal nr. 91/2001, datë 22.02.2001, nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali.
Me vendimin nr. (11-2015-1517) 173, datë 02.04.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë pranë kësaj gjykate, duke hequr masën e sigurimit personal "Arrest në Burg" të caktuar me vendimin nr. 65, datë 18.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për këtë shtetas, për arsye të shuarjes së kësaj mase sigurimi me vendimin penal nr. (11-2011-3924) 560, datë 26.07.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 441, datë 06.06.2011, masa shtrënguese e sigurisë personale "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, me qëllim njohjen e vendimit penal nr. 91/2001 të dhënë me datë 22.02.2001 nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali, i cili e ka dënuar me 6 (gjashtë) vjet burgim (mbetur pa u shlyer 3 vjet burgim) për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian në lidhje me nenet 73 paragrafi 1 e 6 dhe 80 paragrafi 2 DPR 309/90. Me vendimin nr. 176, date 02.08.2011, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur të mos pranojë ankimin e bërë kundër vendimit nr. 441, datë 06.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të heqjes dorë nga i dyshuari. Me vendimin penal nr. (11-2011-3924) 560, datë 26.07.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shuarjen e masës shtrënguese të sigurisë personale "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale;
- Rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal Italian në lidhje me nenet 73 paragrafi 1 e 6 dhe 80 paragrafi 2 DPR 309/90, të kryer me 18 korrik 1996, nga autoritetet ligjzbatuese italiane, në bazë të urdhër arrestit nr. 13/2001 të lëshuar nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali për ekzekutimin e vendimit penal nr. 91/2001, date 22.02.2001. Ky urdhër kërkimi ndërkombëtar është anuluar më datë 18.08.2016;
- Rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga Gjykata e Isernias me vendimin datë 21 shkurt 1997, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Campobasso në Itali me vendimin nr. 91/2001, date 22.02.2001;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion, me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qenien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

- përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se z. **Qazim Halil Bici** në bazë të vendimit penal nr. 91/2001, datë 22.02.2001, të Gjykatës së Apelit të Campobasso në Itali, është deklaruar fajtor për veprën penale “Trafikimit të lëndëve narkotike” duke konvertuar, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim”.

Referuar shkronjës a, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, **283/a**, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal.

Vepra penale “Trafikimi Narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a, i Kodit Penal, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar nga neni 2, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.138/2015.

Z. Qazim Halil Bici gjithashtu nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit gjenealitetet e tjera të përdorura prej tij, që sipas rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm janë **Ardian Arukaj, Gëzim Shala dhe Fabrizio Albartimi**.

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar gjenealitete të tjera të mëparshme të përdorura prej tij, gjë që bie ndesh me pikën 3, shkronja “ç”, të Kreut III të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit parashikohet se:....*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të*

paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

Subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 578, datë 24.05.2023 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Shijak, qarku Durrës, dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023. Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka fituar 1 (një) mandat dhe z. Qazim Halil Bici, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023, Këshilli i Bashkisë Shijak, qarku Durrës, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit të bashkisë. Duke qenë se subjekti, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, ka marrë 1 (një) mandat në Këshillin e Bashkisë Shijak, Qarku Durrës, kandidati z. Qazim Halil Bici, i renditur në listë me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë), potencialisht mund të përfitojë mandatin e anëtarit të këshillit për këtë legjislaturë.

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se kandidati për anëtar këshilli, z. Qazim Halil Bici, referuar pikës 3, shkronjës “ç”, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, nenit 2, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 4, pika 1 e ligjit 138/2015 është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit në funksion publik.

Bazuar në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, “...shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor...”;

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 1, pika 2, shkronja “a” dhe neni 4, pika 1 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Ndalimin për të ushtruar funksionin publik të z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, i propozuar nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI